

L I G J
Nr.7845, datë 13.7.1994

PËR NUMRIN E SIGURIMIT SHOQËROR

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 “Për dispozitat kryesore kushtetuese”, me propozim të Këshillit të Ministrave,

KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I :

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Përkufizime

Me “Numër Sigurimi Shoqëror” kuptohet një bashkësi e radhitur elementësh.

Me “element” të Numrit të Sigurimit Shoqëror kuptohet një numër ose shkronjë.

Me “person i siguruar” kuptohet i siguruari sipas legjislacionit për sigurimet shoqërore dhe për sigurimet shëndetësore në Republikën e Shqipërisë.

Me “Kartë Sigurimi Shoqëror” kuptohet një dokument identifikues.

Me “Regjistër Qendror të Numrit të Sigurimit Shoqëror” kuptohet bashkësia e të dhënave të të gjithë personave të siguruar.

Neni 2

Numri i Sigurimit Shoqëror përcakton identitetin e personit të siguruar.

Neni 3

Numri i Sigurimit Shoqëror shërben:

- a) Për të identifikuar personat për të cilët derdhen kontribute.
- b) Për të regjistruar kontributet e derdhura.
- c) Për të kërkuar përfitime nga:
Sigurimet Shoqërore,
Sigurimet Shëndetësore
dhe Programe të tjera të Mbrojtjes Shoqërore.
- d) Për të regjistruar përfitimet.
- e) Për nevojat e institucioneve shtetërore kur autorizohen me vendim të Këshillit të Ministrave.
- f) Për nevojat e institucioneve joshtetërore kur autorizohen me ligj.

Neni 4

I siguruari e përdor Numrin e Sigurimit Shoqëror në marrëdhënie me Institutin e Sigurimeve Shoqërore dhe institucione të tjera të autorizuar me ligj ose me vendim të Këshillit të Ministrave kur:

- a) paguan kontribute,
- b) kërkon përfitime,
- c) tërheq përfitime,
- d) përcaktohet me ligj për raste të tjera.

Neni 5

Punëdhënësi e përdor Numrin e Sigurimit Shoqëror në marrëdhënie me Institutin e Sigurimeve Shoqërore, për të identifikuar kontributet e derdhura për të punësuarin.

Punëdhënësi e shënon Numrin e Sigurimit Shoqëror në të dhënat vetjake që mban për të punësuarin.

Punëdhënësi e përdor Numrin e Sigurimit Shoqëror për qëllime të tjera vetëm kur është i autorizuar nga punëmarrësi.

KREU II

STRUKTURA DHE EMETIMI I NUMRIT TË SIGURIMIT SHOQËROR

Neni 6

Numri i Sigurimit Shoqëror ka 10 elemente që tregojnë të dhëna mbi ditëlindjen, gjininë, numrin pasues serial të personave të lindur në po atë datë dhe elementin e kontrollit.

Neni 7

Numri i Sigurimit Shoqëror emetohet nga Zyra Qendrore e Institutit të Sigurimeve Shoqërore.

REGJISTRIMI QENDROR I NUMRIT TË SIGURIMIT SHOQËROR

Neni 8

Instituti i Sigurimeve Shoqërore krijon dhe administron Regjistrin Qendror të Numrit të Sigurimit Shoqëror.

Neni 9

Regjistri Qendror i Numrit të Sigurimit Shoqëror është i veçantë. Kopja e tij ruhet në një bankë të zgjedhur nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore.

Kopje të pjesëve përkatëse të Regjistrit Qendror ruhen në Zyrat Rajonale të Sigurimeve Shoqërore.

Neni 10

Regjistri Qendror i Numrit të Sigurimit Shoqëror dhe kopjet e tij janë sekret. Personi që punon me ato ose autorizohet t'i përdorë ato, është i detyruar të ruajë fshehtësinë e tyre.

KARTA E SIGURIMIT SHOQËROR

Neni 11

Karta e Sigurimit Shoqëror i shërben personit të siguruar në marrëdhëniet e tij me Institutin e Sigurimeve Shoqërore dhe institucione të tjera të autorizuara me ligj ose vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 12

Karta e Sigurimit Shoqëror emetohet nga Zyra Qendrore e Institutit të Sigurimeve Shoqërore.

KREU III

DISPOZITA KALIMTARE DHE TË FUNDIT

Neni 13

Këshilli i Ministrave nxjerr aktet nënligjore për zbatimin e neneve 6, 7 e 12 të këtij ligji.
Instituti i Sigurimeve Shoqërore përcakton përmbajtjen e Regjistrit Qendror të Numrit të Sigurimit Shoqëror dhe formën e Kartës së Sigurimit Shoqëror.
Instituti i Sigurimeve Shoqërore ngarkohet të emetojë Numrat e Sigurimit Shoqëror për gjithë personat e siguruar deri në datën 31.12.1994

Neni 14

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në “Fletoren Zyrtare”.

Shpallur me dekretin nr.896, datë 25.7.1994 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Sali Berisha